

V E N D I M
Nr. 575, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONSËIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E
SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Shkodrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Shkodrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 20 000 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Shkodrës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 115 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.

7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Shkodrës.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA SHKODËR**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Vat Nik Boshi	1900	480	912000
2	Gjovalin Rrok Vukelaj	2600	480	1248000
3	Mark Mhill Pjetri	4000	480	1920000
4	Mhill Kolë Pjetri	2400	480	1152000
5	Fran Kolë Pjetri	4400	480	2112000
6	Ali Cuf Mehmetaj	4700	480	2256000
			Shuma	9600000